

## Vendim nr. 226 datë 16.10.2024

Mbledhja e Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga: Holta Zaçaj, Kryetare, Marsida Xhaferllari, Fiona Papajorgji, Sonila Bejtja, Sandër Beci, Ilir Toska, Genti Ibrahimimi, Marjana Semini, anëtarë, në datën 16.10.2024 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 12 (E) 2024 të Regjistrisë Themeltar, që i përket:

**KËRKUESE:** ESMA MALUSHI, përfaqësuar nga avokate Nertila Qordja, me prokurë.

**OBJEKTI:** Shfuqizimi i vendimeve nr. 1231, datë 10.03.2015 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë; nr. 2449, datë 31.05.2017 të Gjykatës Administrative të Apelit; nr. 00-2024-640, datë 22.02.2024 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

**BAZA LIGJORE:** Nenet 4, 17, paragrafi 2, 42, 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; nenet 1, 6 dhe 13 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

Mbledhja e Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese (*Mbledhja e Gjyqtarëve*), pasi dëgjoi relatorin e çështjes Marjana Semini, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

**V Ë R E N:**

**I**

**Rrethanat e çështjes**

1. Kërkuesja Esmalush Malushi është e veja e shtetasit G.M., i cili, në datën 06.08.2003, ka humbur jetën për shkak të detyrës si punonjës i Policisë së Shtetit. Në bazë të vendimit nr. 1637, datë 22.12.2004 të Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore, Tiranë (*DRSSH, Tiranë*), nëna e viktimës, shtetasja B.M., ka përfituar pension suplementar familjar në masën e 100% të pagës referuese të muajit të fundit kalendarik, në vlerën 53.296 lekë. Me pretendimin se paga referuese mbi të cilën ishte llogaritur pensioni suplementar familjar nuk përputhej me gradën që mbante i ndjeri, shtetasja B.M. i është drejtuar gjykatës për rillogaritjen e pensionit, padi e cila është pranuar me vendimin nr. 6929, datë 24.11.2005 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, duke u urdhëruar DRSSH-ja, Tiranë që pensioni suplementar familjar të llogaritej sipas pagës bazë për gradë dhe shtesat mbi pagë për shkak të natyrës së veçantë të detyrës. Në vijim, pas ripërcaktimit të pagës referuese, sipas vendimit gjyqësor, në masën 71.000 lekë, DRSSH-ja, Tiranë ka rillogaritur masën e pensionit suplementar familjar, duke i paguar shtetasen B.M. edhe diferencat nga data 07.08.2003. Ky përfitim i është paguar kësaj shtetaseje deri në datën 25.03.2011, kur ajo ka ndërruar jetë dhe dosja e saj e përfitimit është mbyllur.

2. Në vijim, mbi kërkesën e kërkueses, me vendimin e datës 27.10.2011, DRSSH-ja, Tiranë, bazuar në ligjin nr. 10142 datë 15.05.2009 “Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura, të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit Informativ të Shtetit, të Policisë së Burgjeve, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit e të punonjësve të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar (*ligji nr. 10142/2009*), ka caktuar për të pension suplementar familjar në masën 42.973 lekë, me të drejtë pagese nga data 18.07.2011, ndërsa ajo përfitonte edhe pension familjar në masën 8.763 lekë, sipas ligjit nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore”, të ndryshuar (*ligji nr. 7703/1993*).

3. Ndërkohë, në përgjigje të ankesave të kërkueses, DRSSH-ja, Tiranë i ka bërë me dije se nuk e përfiton pensionin suplementar familjar në vazhdimësi në të njëjtën masë që kishte përfituar e ëma e të ndjerit, pasi me daljen e ligjit nr. 10142/2009 trajtohet si person që i ka lindur e drejta në momentin e kërimit dhe se pensioni i saj suplementar familjar është caktuar në përputhje me këtë ligj, në bazë të pagës referuese neto të të ndjerit, të dërguar nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë (*DPP*), ndërsa rillogaritja e pagës mbështetej në nenin 29 të ligjit nr. 10142/2009 dhe në vendimin e Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) nr. 2/2013.

4. Në datën 17.07.2014, me pretendimin se e drejta e pensionit suplementar familjar është një e drejtë në vazhdimësi, e cila ka lindur që në momentin kur i ndjeri ka humbur jetën për shkak

detyrës, duke iu njohur fillimisht nënës së tij dhe më pas i ka kaluar asaj si bashkëshorte e tij dhe që, për këtë arsye, në respektim të parimit të sigurisë juridike, masa e pensionit suplementar nuk mund të ulet, kërkuesja i është drejtuar gjykatës me kërkesëpadi, me objekt detyrimin e palës së paditur për të paguar pensionin suplementar të fituar sipas kushteve të përcaktuara nga dekreti i Presidentit të Republikës nr. 758, datë 01.02.1994 “Për një mbrojtje të veçantë të ushtarakut” (dekreti nr. 758/1994) dhe neni 40, pikat 2 dhe 3, të ligjit nr. 7703/1993.

5. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, me vendimin nr. 1231, datë 10.03.2015, ka vendosur rrëzimin e padisë, si të pabazuar në ligj dhe në prova. Ky vendim, mbi ankimin e kërkueses, është lënë në fuqi nga Gjykata Administrative e Apelit me vendimin nr. 2449, datë 31.05.2017. Kurse për rekursin e kërkueses, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2024-640, datë 22.02.2024, ka vendosur mospranimin e tij, me arsyetimin se nuk përmbante shkaqe nga ato të parashikuara në nenin 58 të ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, të ndryshuar.

6. Në datën 19.06.2024 kërkuesja i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual, i cili, pas plotësimit sipas parashikimeve të nenit 27 të ligjit nr. 8577/2000, është regjistruar në datën 25.06.2024. Kolegji i Gjykatës në datën 23.09.2024 ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim paraprak në Mbledhjen e Gjyqtarëve. Në lidhje me afatin për shqyrtimin paraprak të çështjes, të përcaktuar në nenin 47, pika 1, të ligjit nr.8577/2000, bazuar në nenet 15, pika 2 dhe 21, pika 1, të Rregullores për Procedurat Gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese, në këtë afat nuk llogaritet periudha e lejes vjetore, sipas nenit 18, pika 1, shkronja “b”, të po këtij ligji.

## II

### Pretendimet e kërkueses

7. **Kërkuesja**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se vendimet objekt kundërshtimi i kanë cenuar:

7.1. *Të drejtën për proces të rregullt ligjor*, të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në drejtim të:

7.1.1. *Parimit të sigurisë juridike*, pasi e drejta e pensionit suplementar familjar është një e drejtë e cila ka lindur në momentin e rënies në detyrë të bashkëshortit të kërkueses. Ky pension është përfituar fillimisht nga e ëma e të ndjerit dhe pasi ajo ka ndërruar jetë, ai vijon të kërkuesja si një e drejtë e fituar. DRSSH-ja, Tiranë ka gabuar kur e ka konsideruar kërkesën e saj për pensionin familjar si kërkesë fillestare, duke i caktuar

asaj një pension rreth 40% më pak se pensioni që përfitonte nëna e të ndjerit. Pensioni suplementar që ka përfituar familja nuk është ndërprerë, rillogaritur ose cenuar asnjëherë nga ndryshimet ligjore. DRSSH-ja, Tiranë ka bërë përlllogaritjen e pensionit që do të përfitonte kërkuesja në masë shumë më të ulët se pensioni që përfitonte më parë e ëma e të ndjerit, ndonëse paga referuese e tij është përcaktuar me një vendim gjyqësor të formës së prerë, në masën 71.000 lekë në muaj, përkundrajt 51.737 lekë që është bazuar DRSSH-ja, Tiranë.

7.1.2. *Standardit të arsytimit të vendimit*, pasi të dy gjykatat kanë zbatuar gabim ligjin material, duke e trajtuar kërkuesen si përfituese për herë të parë dhe nuk e konsiderojnë të drejtën e pensionit suplementar në vazhdimësi që nga viti 2003 kur ka lindur kjo e drejtë për familjarët e të rënit në detyrë. Gjykatat nuk kanë arritur të bëjnë ndarjen midis pensionit të parakohshëm të ushtarakut aktiv dhe atij suplementar familjar.

7.2. *Parimin e barazisë përpara ligjit dhe mosdiskriminimit*, pasi kërkuesja është vendosur në një situatë jo të favorshme, duke u trajtuar në mënyrë të diferencuar dhe pa verifikuar situatën e saj ligjore. Aktualisht familjarëve të tjerë të të rënëve në detyrë nuk i është cenuar e drejta e fituar.

### III

#### Vlerësimi i Mbledhjes së Gjyqtarëve

##### A. *Për legjitimitimin e kërkueses*

8. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuara në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës. Kriteret për pranueshmërinë e kërkesës janë kumulative, në kuptimin që mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që kërkuesi të mos legjitimohet për vënien në lëvizje të gjykimit kushtetues.

9. Kërkuesja, si individ, legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të shkronjës “f” të pikës 1 të nenit 131 dhe shkronjës “i” të pikës 1 të nenit 134 të Kushtetutës, pasi është palë në çështjen objekt të ankimit kushtetues individual, për rrjedhojë ka interes të drejtpërdrejtë në çështjen e parashtruar.

10. Në lidhje me kriterin e *shterimit të mjeteve juridike efektive*, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës, Mbledhja e Gjyqtarëve vëren se kërkuesja i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual pas përfundimit të procesit gjyqësor në të tria shkallët e gjyqësorit të zakonshëm dhe pasi ka shteruar në formë e substancë mjetet e zakonshme të ankimit ndaj vendimeve të gjykatave më të ulëta. Për rrjedhojë, ajo nuk ka mjet tjetër juridik në dispozicion për mbrojtjen e të drejtave të saj kushtetuese përveç paraqitjes së ankimit kushtetues individual.

11. Kërkuesja legjitimohet edhe *ratione temporis*, në kuptim të përmbajtjes së nenit 71/a, pika 1, shkronja “b”, të ligjit nr. 8577/2000, pasi i është drejtuar Gjykatës në datën 19.06.2024, ndërsa vendimi i kundërshtuar, ai i Gjykatës së Lartë, mban datën 22.02.2024, pra brenda afatit ligjor 4-mujor.

12. Për sa i përket legjitimitetit *ratione materiae*, kërkuesja ka pretenduar cenimin e së drejtës për proces të rregull ligjor në drejtim të parimit të sigurisë juridike dhe standardit të arsyetimit të vendimit, si dhe në drejtim të parimit të barazisë përpara ligjit dhe mosdiskriminimit. Për sa i përket këtij të fundit, kërkuesja ka pretenduar se është vendosur në një situatë jo të favorshme, duke u trajtuar në mënyrë të diferencuar dhe pa verifikuar situatën e saj ligjore, kurse familjarëve të tjerë të të rënëve në detyrë nuk i është cenuar e drejta e fituar. Mbledhja e Gjyqtarëve vëren se, bazuar në thelbin e argumenteve, ky pretendim i kërkueses është i ndërvarur me atë për cenimin e procesit të rregullt ligjor dhe duke pasur parasysh që këto pretendime bazohen në argumentet e dhëna nga Gjykata e Lartë për zgjidhjen e themelit të çështjes, ajo çmon t’i analizojë ato në këndvështrim të procesit të rregullt ligjor në aspektin e parimit të sigurisë juridike të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit, të cilat *prima facie* hyjnë në juridiksionin e Gjykatës.

*B. Për pretendimin e cenimit të parimit të sigurisë juridike të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit*

13. Kërkuesja ka pretenduar se e drejta e pensionit suplementar familjar është një e drejtë e cila ka lindur në momentin e rënies në detyrë të bashkëshortit të saj. Ky pension është përfituar fillimisht nga e ëma e të ndjerit dhe pasi ajo ka ndërruar jetë, ai vijon te kërkuesja si një e drejtë e fituar. Sipas saj, DRSSH-ja, Tiranë ka gabuar kur e ka konsideruar kërkesën e saj si fillestare.

Pensioni suplementar që ka përfituar familja nuk është ndërprerë, rillogaritur ose cenuar asnjëherë nga ndryshimet ligjore. DRSSH-ja, Tiranë ka bërë përlogaritjen e pensionit që do të përfitonte kërkuesja në masë shumë më të ulët se pensioni që përfitonte më parë e ëma e të ndjerit, ndonëse paga referuese e tij ishte përcaktuar me një vendim gjyqësor të formës së prerë. Po kështu, sipas kërkueses, të dyja gjykatat kanë zbatuar gabim ligjin material, duke e trajtuar atë si përfituese për herë të parë dhe nuk e konsiderojnë të drejtën e pensionit suplementar në vazhdimësi që nga viti 2003, kur ka lindur kjo e drejtë për familjarët e të rënit në detyrë. Gjykatat nuk kanë arritur të bëjnë ndarjen midis pensionit të parakohshëm të ushtarakut aktiv dhe atij suplementar familjar.

14. Gjykata në jurisprudencën e saj ka theksuar vazhdimisht rëndësinë e parimit të sigurisë juridike, si një nga aspektet themelore të shtetit të së drejtës, duke e parë të lidhur me parimin *res judicata*, sipas të cilit vendimi gjyqësor i formës së prerë, që përbën gjë të gjykuar, është shprehje dhe konkretizim i së drejtës për marrëdhënien juridike dhe ka qëllim t'i japë jo vetëm qartësi, por edhe siguri kësaj marrëdhënieje. Në këtë këndvështrim, për sa u përket të drejtave të fituara, si elemente të parimit të sigurisë juridike, çdo proces ku vihen në dyshim ato nuk mund të konsiderohet se qëndron jashtë nocionit të “procesit të rregullt”. Ky parim është i detyrueshëm të respektohet në të gjitha fazat e një procesi ku pretendohet cenimi i të drejtave të fituara dhe siguria juridike që rrjedh prej tyre (*shih vendimet nr. 10 datë 07.03.2023; nr. 22, datë 29.09.2022; nr. 10, datë 13.02.2017 të Gjykatës Kushtetuese*).

15. Nga ana tjetër, Gjykata ka pranuar edhe se arsyetimi i vendimeve është element thelbësor i një vendimi të drejtë. Funkcioni i një vendimi të arsyetuar është t'u tregojë palëve që ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë. Sipas saj, vendimet e mospranimit të rekursit të Gjykatës së Lartë mund të arsyetohen në mënyrë të kufizuar, me kusht që në pjesën hyrëse të listohen shkaqet e rekursit. Ky arsyetim i kufizuar nuk cenon standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor, përderisa, në thelb, shpreh shkaqet e mospranimit të rekursit nga ana e kolegjeve të saj (*shih vendimet nr. 10, datë 07.03.2023; nr. 2, datë 11.02.2021; nr. 21, datë 16.04.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

16. Po kështu, Gjykata ka pohuar se mënyra se si gjykatat e zakonshme kanë përcaktuar faktet dhe kanë interpretuar ligjin e zbatueshëm në zgjidhjen e mosmarrëveshjes në shqyrtim përpara tyre nuk përbën lëndë kushtetuese, me përjashtim të rastit kur kjo mënyrë veprimi e gjykatës së zakonshme provohet se ka cenuar të drejtat kushtetuese të individit që vë në lëvizje këtë Gjykatë, në kuptimin që procesi në tërësinë e tij rezulton haptazi i paarsyeshëm ose arbitrar (*shih vendimin nr. 38, datë 02.12.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

17. Nën dritën e standardeve të mësipërme kushtetuese, Mbledhja e Gjyqtarëve, duke mbajtur në konsideratë se kërkuesja ka ngritur pretendime në drejtim të faktit se e drejta e përfitimit të pensionit suplementar ishte vijuese dhe gjykatat në vendimmarrjen e tyre nuk kishin marrë për bazë masën e pensionit të caktuar me vendim gjyqësor të formës së prerë do të analizojë nëse gjykatat e kanë marrë në shqyrtim këtë fakt dhe nëse kanë dhënë arsye të mjaftueshme për zgjidhjen e dhënë mosmarrëveshjes objekt shqyrtimi.

18. Duke iu kthyer çështjes konkrete, Mbledhja e Gjyqtarëve vëren se legjislacioni i kohës në momentin kur bashkëshorti i kërkueses ka humbur jetën për shkak të detyrës dhe nëna e tij ka përfituar pension suplementar familjar, ka qenë dekreti nr. 758/1994. Me këtë dekret, krahas disa shtesave të bëra në Kodin Penal, për pjesëtarët e familjes së ushtarakut që humbet jetën për shkak të detyrës, është njohur e drejta e pensionit familjar në masën 100% të pagës mujore të muajit të fundit kalendarik të shërbimit, ndërsa pjesëtarët e familjes dhe kushtet në të cilat ata e përfitonin këtë pension përcaktoheshin në nenin 40, pika 2 dhe 3, të ligjit nr. 7703/1993. Pensioni familjar jepej në emër të njërit nga përfituesit, sipas radhës së përcaktuar në nenin 40, pika 2, të ligjit nr. 7703/1993 dhe në rastet kur lindte nevoja e ndarjes së pensionit familjar, masa konkrete për secilin përfitues caktohej me vendim gjyqësor. Po kështu, pjesë e legjislacionit të kohës ka qenë edhe ligji i veçantë nr. 8087, datë 13.03.1996 (*ligji nr. 8087/1996*) për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura (ku sipas ligjit të kohës përfshiheshin dhe forcat e Ministrisë së Brendshme), përmes të cilit ishte rregulluar edhe e drejta e pensionit suplementar familjar për pjesëtarët e familjes në ngarkim të ushtarakut që për shkak të detyrës humbet jetën. Sipas këtij ligji, kjo e drejtë u është njohur pjesëtarëve të familjes që përfitonin pension familjar sipas ligjit nr. 7703/1993, ndërsa masa e pensionit suplementar familjar përcaktohej si diferencë ndërmjet pagës referuese dhe pensionit familjar sipas ligjit nr. 7703/1993. Nga ana tjetër, paga referuese, sipas këtij ligji, përbëhej nga paga bazë për funksion dhe shpërblimi për gradën ushtarake.

19. Ndërkohë, në momentin kur kërkuesja ka kërkuar dhe i është caktuar pension suplementar familjar si bashkëshorte e punonjësit të Policisë së Shtetit të rënë në krye të detyrës, legjislacioni për sigurimin suplementar edhe të punonjësve të Policisë së Shtetit ka pësuar ndryshime, ndërsa ishte miratuar ligji nr. 10142/2009, përmes të cilit janë shfuqizuar dekreti nr. 758/1994 dhe ligji nr. 8087/1996. Edhe ligji i ri ka njohur të drejtën e pensionit suplementar familjar për pjesëtarët e familjes në ngarkim të punonjësit të Policisë së Shtetit që humbet jetën në detyrë ose për shkak të saj, të cilët përfitojnë pension familjar sipas ligjit nr. 7703/1993. Masa e pensionit suplementar familjar, sipas ligjit të ri, përcaktohet të jetë sa diferenca ndërmjet pagës referuese neto

të të ndjerit në çastin e humbjes së jetës dhe pensionit familjar sipas ligjit nr. 7703/1993. Për sa i përket pagës referuese, ajo përcaktohet se përbëhet nga paga bazë mujore për gradë ose paga bazë mujore për funksion dhe shtesat mbi pagë, në datën e lindjes së të drejtës së përfitimit. Kurse, për sa i përket pagës referuese neto, ajo përcaktohet se është paga që rezulton pas zbritjes, nga paga referuese, të kontributit të detyrueshëm të sigurimit shoqëror dhe shëndetësor plus tatimin mbi të ardhurat personale, plus kontributin suplementar, sipas këtij ligji, të cilat mbahen nga paga. Nga ana tjetër, ligji i ri ka parashikuar edhe rilogaritjen e të drejtave të njohura, duke përcaktuar se edhe pensionet suplementare të caktuara sipas ligjit nr. 8087/1996, si edhe ato të caktuara me vendime të gjykatave, do të rilogariten, e cila bëhet sipas rregullave të përcaktuara në këtë ligj dhe në bazë të pagave referuese neto, në çastin që i ka lindur e drejta për përfitim (neni 29).

20. Gjykata vëren se kërkueses i është caktuar pensioni suplementar familjar sipas parashikimeve të reja ligjore, gjë të cilën ajo e ka kundërshtuar gjyqësisht, por gjykatat e kanë rrëzuar padinë e saj me arsyetimin se DRSSH-ja, Tiranë ia ka caktuar pensionin në përputhje me ligjin në fuqi në çastin e lindjes së të drejtës së kërkueses për këtë përfitim suplementar, në masën sa diferenca ndërmjet pagës referuese neto të të ndjerit në çastin e humbjes së jetës dhe pensionit familjar që ajo përfitonte sipas ligjit të sigurimeve shoqërore. Gjykatat nuk kanë pranuar pretendimin e kërkueses se e drejta e pensionit suplementar familjar ishte në vazhdimësi të së drejtës së njohur nënës së të ndjerit, duke arsyetuar se asaj i ka lindur e drejta për këtë përfitim suplementar vetëm pas plotësimit të kushteve për pension familjar sipas ligjit nr. 7703/1993. Po kështu, gjykatat nuk kanë pranuar edhe pretendimin e kërkueses për llogaritjen e pensionit suplementar familjar, sipas pagës referuese të të ndjerit të përcaktuar me vendim gjyqësor, duke arsyetuar se, si e tillë, është ajo sipas përcaktimeve të ligjit të ri të zbatueshëm, i cili zbatohet edhe në ato raste kur pensioni është caktuar me vendim gjyqësor, rregullim ligjor ky që është gjetur në pajtim me Kushtetutën, me vendimin nr. 2/2013 të Gjykatës, në të cilin është evidentuar se natyra e sigurimit shoqëror suplementar është e ndryshme nga sigurimi shoqëror bazë.

21. Ndërkohë që shkaqet e rekursit për të kundërshtuar vendimmarrjen e gjykatave të faktit nuk janë pranuar nga Gjykata e Lartë, e cila ka vlerësuar se atyre u është dhënë përgjigje shteruese nga të dyja gjykatat më të ulëta. Sipas Gjykatës së Lartë, gjykata e apelit i ka bërë një analizë të hollësishme dispozitave të ligjit, duke e interpretuar me përpikëri atë, ndërsa nuk rezulton zbatim i gabuar i ligjit material ose procedural, i cili të jetë i një rëndësie themelore për njësimin, sigurinë dhe/ose zhvillimin e praktikës gjyqësore. Po kështu, sipas saj, vendimmarrja e gjykatave më të ulëta nuk bie ndesh me praktikën e konsoliduar të Kolegjit Administrativ ose vendimet e Kolegjeve



të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, kurse çështja e vlerësimit të provave del jashtë juridiksionit rishikues dhe ekskluzivisht ligjor të saj.

22. Në analizë të rrethanave të faktit, Mbledhja e Gjyqtarëve, paraprakisht, çmon të evidentojë qasjen që Gjykata ka pasur në rastet kur ka shqyrtuar kushtetutshmërinë e legjislacionit të kohës që ka zbatuar të drejtën kushtetuese për pension. Gjykata ka vlerësuar se shteti duhet të synojë të ndryshojë një situatë të rregulluar më parë vetëm nëse ndryshimi sjell pasoja pozitive, konkretisht trajtim më të mirë financiar për subjektet përfituese. Për rrjedhojë, sipas Gjykatës, rillogaritja e të drejtave të fituara në zbatim të ligjeve të mëparshme ose dhe të vendimeve të gjykatave, do të bëhet vetëm në rast se ndryshon pozitivisht, pra përmirëson situatën e përfituesve, duke vendosur detyrimin për interpretimin pajtues të nenit 29 të ligjit nr. 10142/2009, i cili parashikon rillogaritjen e të drejtave të njohura në zbatim të ligjeve të mëparshme, si dhe ato të caktuara me vendime të gjykatave (*shih vendimin nr. 33, datë 24.06.2010 të Gjykatës Kushtetuese*).

23. Në vijim, Kuvendi ka miratuar aktin normativ me fuqinë e ligjit, i cili vendoste si pagë referuese mujore me qëllim llogaritjen e pensionit suplementar pagën mujore neto. Gjykata e vënë përsëri në lëvizje për shfuqizimin e këtij akti, pohoi se ndryshimi i skemës së përfitimeve suplementare mbetet në diskrecion të politikave dhe mundësive të ekzekutivit, kurse prekja e skemës së sigurimeve shoqërore bazë nuk duhet kurrsesi të pësojë ndryshime të tilla që të përkeqësojë ndjeshëm jetën e shtetasve që përfitojnë këtë sigurim. Për këtë shkak, Gjykata ka pranuar se rillogaritja e pensioneve konsiderohet interes publik që e justifikon ndërhyrjen e ligjvënësit në skemën e sigurimeve suplementare dhe ndonëse skema e re e llogaritjes së masës së sigurimit suplementar ka sjellë uljen e të ardhurave për përfituesit si pasojë e vendosjes si pagë referuese pagën mujore neto, ajo nuk cenon parimin e sigurisë juridike (*shih vendimin nr. 2, datë 18.02.2013 të Gjykatës Kushtetuese*).

24. Në kontekst të sa më sipër, Mbledhja e Gjyqtarëve vë në dukje se e drejta për përfitimin e pensionit suplementar familjar ka natyrë individuale për përfituesin që aplikon, i cili në kohën e aplikimit duhet të plotësojë kushtet për përfitimin e pensionit familjar sipas ligjit nr. 7703/1993. Një kusht i tillë është përcaktuar në vijimësi që nga dekreti nr. 758/1994 dhe deri në ligjin e veçantë aktual nr. 10142/2009. Në rastin konkret, Mbledhja e Gjyqtarëve vëren se në momentin kur ka ndodhur humbja e jetës së bashkëshortit të kërkueses, kjo e fundit nuk plotësonte kushtet për përfitimin e pensionit suplementar familjar, ndërsa nuk plotësonte kushtet për përfitimin e pensionit familjar sipas ligjit nr. 7703/1993, pikërisht atë të moshës, ndaj ky pension suplementar

iu akordua në momentin e paraqitjes së kërkesës dhe plotësimin nga ajo të kushteve ligjore për këtë përfitim suplementar. Pikërisht në atë moment, DRSSH-ja, Tiranë ka llogaritur dhe masën e këtij përfitimi suplementar, bazuar në kriteret ligjore në fuqi (*ligji nr. 10142/2009*), duke iu referuar për këtë qëllim të dhënave për pagën referuese neto të dërguara nga DPP-ja. Ndërkohë kjo analizë gjendet e pasqyruar mjaftueshëm në vendimmarrjen e gjykatave të faktit, ndërsa vlerësimi i tyre është gjetur i pacenueshëm edhe nga Gjykata e Lartë, që e ka vlerësuar si të papranueshëm rekursin e kërkueses.

25. Në vështrim të sa më sipër, Mbledhja e Gjyqtarëve çmon se pretendimi kryesor i kërkueses që lidhet me cenimin e parimit të sigurisë juridike, me argumentin se e drejta për pensionin i ka lindur në vitin 2003 nuk qëndron, në kushtet kur e drejta e pretenduar nuk përbën një të drejtë të fituar. Po kështu, për sa kohë pretendimi i kërkueses për cenimin e procesit të rregullt ligjor është haptazi i pabazuar, rrjedhimisht edhe pretendimi për cenimin e parimit të barazisë përpara ligjit dhe mosdiskriminimit, i ndërvarur nga procesi, është haptazi i pabazuar.

26. Në përfundim, Mbledhja e Gjyqtarëve çmon se ankimi kushtetues individual nuk plotëson kriteret ligjore paraprake për pranimin e tij për shqyrtim në seancë plenare.

### **PËR KËTO ARSYE,**

Mbledhja e Gjyqtarëve, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, shkronja “e”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, njëzëri,

### **V E N D O S I:**

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.